

# “RIJETËSIMI I PIRAMIDËS SË TIRANËS”

HYDRO&ENERGY

## RAPORTI TEKNIK DHE METODOLOGJIA E PROJEKTIMIT

INSTALIMET E BRENDSHME-INFRASTRUKTURA E JASHTME-KODET E PROJEKTIMIT



HE 06-22-2020

HYDRO & ENERGY  
MEP Engineering



- KAPITULLI NR. 1. PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM
- KAPITULLI NR. 2. PROJEKTI HIDROSANITARE
- KAPITULLI NR. 3. PROJEKTI HVAC
- KAPITULLI NR. 4. PROJEKTI I MBROJTJES NDAJ ZJARRIT
- KAPITULLI NR. 5. PROJEKTI I INFRASTRUKTURA SE JASHTME
- KAPITULLI NR. 6. KODET DHE STANDARTET



## KAPITULLI NR.1

## PERSHKRIM I PERGJITHSHEM

Ky raport teknik paraqet metoden e zgjidhjes dhe llogaritjeve inxhinierike qe jane hartuar projektet e instalime te brendshme dhe infrastruktura inxhinierike te jashtme te objektit Piramida sipas specialitetave te meposhtme:

- Projekti hidrosanitar
- Projekti kondicionimit dhe ventilimit
- Projekti i sistemit gjeotermal
- Projekti i sistemit me sprinkler
- Projekti i hidranteve te brendshem dhe te jashtem
- Projekti i ujites se siperfaqeve te mbjella
- Projekti i ujrave te shiut dhe kanalizimit te ujrave te zeba
- Projekti i ujesjellesit te jashtem

Projektet jane hartuar duke u mbeshtetur ne kushtet teknike shqiptare dhe ato europiane si edhe produkteve qe nxjerrin prodhues te ndryshem europian.

Ky material duhet te merret ne konsiderate se bashku me vizatimet teknike, specifikimet teknike, referencat e prodhueseve te ndryshem dhe preventivat perkates.

Ky raport eshte hartuar pas perfundimit te projekti dhe do te jete edhe baze per llogaritjet inxhinierike ne rastet e kerkuara nga Supervizori gjate zbatimit te punimeve ne objekt.



## KAPITULLI NR.2

## PROJEKTI HIDRO-SANITAR

### 2.1 REZERVA UJORE

#### 2.1.1 Llogaritja e sasise se ujit

Sasia e ujit per konsum banore/ambiente sherbimi percaktohet ne baze te sasise te ujit per banore/dite dhe rendesise se objektit qe furnizohet.

Normativa per godina multifunksionale e ndan konsumin sipas tipit te perdonimit te ambienteve te saj.

Sasia e depozituar e ujit per konsum eshte llogaritur e barabarte me sasine ditore te konsumit.

Per pjesen e klasave dhe ambienteve te zyrave eshte marre normativa per shkolla dhe perdonues te ngashem qe eshte 25 litra /person.

Numri i personave qe kane akses ne sherbime eshte 3591 vete.

Ne lidhje me ambientet e sherbimit eshte marre ne normativa e rezerves se ujit per banore dhe ajo e siperfaqes se shfrytezuar per banore.

Volumi i ujit ambientet e sherbime eshte marre duke marre ne konsiderate sasine ditore per person (7 litra/person)

Volumi total i ujit te depozituar qe llogaritur eshte shuma e te gjithe konsumatoreve eshte bazuar ne rekomandimet me te fundit nga vendet europiane.

Lloji i godines/perdonimi	Minimumi i rezerves per uje te ftohte + ngrohte
<i>Restaurant</i>	<i>7 litra per klient</i>
<i>Shkolle</i>	<i>25 litra per nxenes</i>
<i>Kinema</i>	<i>3 litra per person</i>

#### 2.1.2 Rezervuari i ujit

Rezervuaret e ujit jane projektuar prej PE per perdonim ushqimor dhe per vendosje nentoke.

Te gjitha rakorderite valvulat ku kalon uji duhet te jene prej gize sferoidale dhe te certifikuara per uje te pijshem nga komuniteti européen.

Elementet e rezervuarit jane te gjitha prej materiali, gize sferoidale ose inox te certifikuara per uje te pijshem dhe rezistente ndaj zjarrit **Euroclass A1** sipas normes BS EN 10255:2004

Volumi i rezerves se ujit eshte marre  $100 \text{ m}^3$  i vendosur ne 2 rezervuar nga 50,000 litra secili.

#### 2.1.3 Cilesia e ujit

Uji qe do te depozitohet dhe pastaj do te shperndahet ne rrjet duhet perpara venies ne pune te rezervuarve dhe pompave te analizohet per elemenet kimik dhe bakteorologjik sipas normatives per uje te pijshem.

Per te bere te mundur sigurine bakteriologjike dhe fizike te tij eshte vendosur nje filter sedimentar perpara futjes ne rezervuar dhe llambe UV ne dalje te pompes.

Nese rezulton i papershtatshem nga analizat duhet trajtuar me sistem filtrimi te percaktuar nga specialisti perkates.

#### 2.2 SHPERNDARJA E UJIT

Sistemi i shperndarjes se ujit brenda godines do te jete me tubacione celik te galvanizuar deri tek kolektori perkates qe do te jete i ndertuar prej polipropileni. Nga kolektori furnizimi i cdo aparati sanitari eshte bere me tubacion me shume shtresa PeX-Al sipas dimensioneve te treguar ne vizatime.

#### 2.2.1. Llogaritja e prurjes

Llogaritja e sasise se ujit behet bazuar ne kohezgjatjen e pikut dhe sasise se ujit te cdo grupi/linje sanitare. Vlera e tyre varet nga:

prurja nominale e grupit/linjes sanitare ; numri i grupeve/linjave sanitare; tipi I perdonuesit; shpeshtesa e perdonimit; kohezgjata e pikut etj. qe bejne te mundur llogaritjen e tyre sipas njekoheshmerise se perdonimit:

Metoda e ekuivalenteve

1 ekuivalent (UC) eshte e barabarte me  $Q_{nom}$  prej  $0,1 \text{ l/s}$ .

Tabela e prurjeve nominale dhe atyre minimale dhe njehesimit te tyre ne ekuivalent:

Tipi aparatit sanitar	$Q_{nom}$	$Q_{min}$	Ekuivalenti
	l/s	l/s	
<i>Lavaman, Bide, Wc me kasete</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>1</i>
<i>Wc flush valve</i>	<i>1</i>	<i>1</i>	<i>10</i>



<i>Lavapjate guzhine, Lavatrice familjare, larese enesh</i>	0.2	0.15	2
<i>Pisuar</i>	0.3	0.15	3
<i>Vaske familjare</i>	0.4	0.3	4
<i>Rubinet garazhdi/kopshti</i>	0.5	0.4	5
<i>Lavapjat per guzhina jo-familjare dn 20, vaske banje jo-familjare</i>	0.8	0.8	8

Llogaritjet e sistemit te furnizimit me uje behen ne baze njekohshmerise se perdorimit te paisjeve sanitare per ambjente sherbimi, ku metoda e perdorur eshte ajo e shumes se ekuvalenteve te gjithe aparateve sanitare si me poshte:

Shpejtesite llogaritese te ujit ne tubacione nuk duhet te kalojne vlerat e meposhtme:

Tubacioni	Shpejtesia e levizjes
Dn 20	0.9 m/s
Dn 25	1.2 m/s
Dn 32	1.3 m/s
Dn 40	1.6 m/s
Dn 50	1.9 m/s
Dn 75	2.0 m/s

Uji i ngrohte do te prodhohet nga ngrohes elektrik lokal, per cdo grup sanitar.

Te gjitha tubacionet e ujit shtrohen me nje pjerresi ne drejtim te rrjedhjes prej 5/1000.

## 2.3 STACIONI I POMPIMIT

Ne godine sigurohet uje gjate 24-oreve pa nderprerje nepermjet rezervuareve dhe me nje sistem pompash me karakteristikat e duhura sipas projektit te paraqitur.

Grupi i pompimit eshte me dy pompa me shpejtesi variabel qe punojne ne baze te kerkeses se konsumatorit, motori elektrik duhet te jete i tipit me inverter me karakteristika pune  $Q=8 \text{ l/s}$  dhe  $H = 60 \text{ meter}$ .

Montimi, lidhja dhe leshimi me pune i grupit te pompimit duhet te jete ne perputhje me specifikimet teknike te prodhuesit.

Te gjitha pjeset e pompes duhet te jene te certifikuar per uje te pijshem.

## 2.4. SHKARKIMET SANITARE

### 2.4.1 Llogaritja e shkarkimeve

Sistemi i shkarkimeve eshte realizuar i bazuar ne projektin arkitektonik dhe ate konstruktiv te paraqitur. Kolektoret e brendshem horizontal shoqerohen me rakorderi per mbrojtje nga ndryshimet termike dhe per pastrimin e tyre. Te gjitha kolektoret horizontal brendshem dhe te jashtem llogariten ne baze te prurjeve llogaritese te aparateve sanitare te nje tipi, numri i tyre si dhe njekohshmeria e perdorimit te tyre. Prurja e llogaritur merret ne baze te tipit te perdoruesve qe ne rastin tone per banesa eshte:

$$Q_{II} = 1 \times \sqrt{Nt}$$

Ku kemi:

$Q_{II}$  prurja llogaritese

$K$  koeficient perdorimit

$N_{as}$  shuma e pergjithshme e prurjeve te cdo aparati sanitar

Ku ekuivalentet e te gjithe aparateve sanitare jane shprehur si me poshte:

Tipi i aparatit sanitar	Prurja minimale (l/s)
Wc	2.0
Lavaman, Bide	0.3
Pllake dushi, Pilete dyshemeje,	1.0

Diametrat nominal te perdorur dhe pjerresite per sistemin e kanalizimit brenda nyjeve sanitare jane marre si me poshte:

Karakteristikat e aparateve sanitare:

Tipi i aparatit	Diametri minimal	Pjerresia min %
Wc	Dn 90	1
Lavaman, Bide	Dn 40	1
Pllake dushi, Pilete dyshemeje	dn 50	1



dyshemeje,		
------------	--	--

Koeficienti i perdonimit:

Tipi i perdonuesit	K
Objekte banimi dhe zyra	0.5
Spitale, shkolla, ristorante, hotele	0.7
Tualete publike	1.0
Laboratore dhe objekte speciale	1.2

Detajet teknike jane te paraqitura ne planimetrite perkatese te instalimeve dhe te shoqueruara me shenimet e nevojshme tekniqe.

#### 2.4.2 Tubacionet e shkarkimeve dhe pjeset te tjera

Tubacionet e linjave te shkarkimit jane marre prej materiali plastik PVC me gomina per shkarkimet me gravitet dhe ajrimin e linjave te shkarkimeve. Materiali PVC ka nje rezistence ndaj zjarrit **B s2 d0** sipas standartit EN13501:2007. Per linjat shkarkimeve me presion jane perdonur ato prej metali, gize ose celik i galvanizuar.

#### 2.6. GRUPET FURNIZIMIT ME UJE DHE APARATET SANITARE

Aparatet sanitare qe do te perdoren jane zgjedhur ato per ambiente publike te sigurta nga demtimet e jashtme fizike.

WC Jane projektuar te tipit te varur pervec se atyre per PAK qe jane sipas percaktive perkatese te normativave europiane.

Lavamanet jane te fiksuar ne banko mbajtese dhe te pajisur secili me sifon perkatese perpara lidhjese me tubacionin perkates.

Grupet e furnizimit jane perzgjedhur te jene per ambiente publike me perdonim te shpeshte dhe rezistente ndaj goditjeve fizike.

Grupet e furnizimit me uje Jane zgjedhur me prurje te kontrolluar dhe sasi konsumi minimale.

- *Furnizuesi i WC eshte zgjedhur me flush valve te tipit antivandal dhe me prurje minimale 60 l/min.*
- *Grupi i lavamanit eshte zgjedhur me mixer antivandal me kohemates me prurje 3 l/min dhe kohezgjatje perdonimi 7-15 seonda ± 5 sec, rregullues temperatura, mbrojtës ndaj grushtit hidraulik.*

Detajet teknike jane te paraqitura ne planimetrite perkatese te instalimeve dhe te shoqueruara me shenimet e nevojshme tekniqe.

#### 2.7. Konkluzione, rekomandime dhe pritshmerite e projektit.

Projekti hidro-sanitar eshte projektuar bazuar ne normat europiane duke marre parasysh funksionimin me te pershtatshem te sistemit te shkarkimit te ujrate te zesa, pa zhurme, aroma dhe funksionim sa me te thjeshte te tyre. Sistemi i furnizimit me uje sanitar eshte perzgjedhur me sistem pompimi dhe grupe per aparatet sanitare me eficience te larte dhe harxhim minimal te ujit.



## KAPITULLI Nr.3

## PROJEKTI HVAC

### 3.1 Kriteret e projektimit

Objekti i projektimi eshte i vendosur ne zonen e Tiranes, per te cilin kushtet e jashme projektuese jane percaktuar si me poshte :

- Temperature e jashme llogaritese per stinen e ftohte -  $1^{\circ}\text{C}$ , lageshtia relative 80%.
- Temperature e jashme llogaritese per stinen e ngrohte  $+35^{\circ}\text{C}$ , lageshtia relative 55%.

Nisur nga destinacioni i godines, per kushtet e brendshme do te merret ne konsiderate :

- Per stinen e ftohte Temperatura per ambientet e komerciale  $20^{\circ}\text{C}$ .
- Per stinen e ngrohte Temperatura per ambientet e komerciale  $25^{\circ}\text{C}$ .

### 3.2 Perllogaritje e sistemit

#### 3.2.1 Ngarkesa Ngrohese

Jane llogaritur humbjet me transmetim te godinese dhe ato per ventilimin .

Humbjet me transmetim :

$$Q_T = S * u * Dt$$

*Q – humbjet e nxehtesise*

*S – siperfaqe e jashme e objektit ( mure , dritare , solete , dysheme )*

*u – koeficienti i humbjeve te nxehtesise , varesi e materialeve te perdonura*

*Dt- diferenca e temperatures jashte - brenda*

Temperaturat :

Temperatura e jashtme llogaritese per Tiranen eshte marre  $-1^{\circ}\text{C}$

Temperatura brenda objektit ne varesi te ambjenteve sic eshte treguar me lart .

Koeficente e humbjeve jane marre si me poshte:

- |   |                                 |
|---|---------------------------------|
| • <i>Mure te jashtem te objektit te termoizoluar</i>    | <i>u = 0.6 w/m<sup>2</sup>K</i> |
| • <i>Dritare duralumini me ndarje termike dopioxham</i> | <i>u = 1.5 w/m<sup>2</sup>K</i> |
| • <i>Dysheme/solete beton i armuar</i>                  | <i>u = 1.4 w/m<sup>2</sup>K</i> |

Llogaritjet rriten me 10% per efekt te urave termike.

Llogaritje e humbjeve ne ventilim jane bazuar ne formulen e meposhtme:

$$Q_V = V * r * Dt * \eta$$

*Q – humbjet e nxehtesise,*

*V – Volumi i ajrit ventilues,*

*r – koeficienti i nxehtesise specifike te arit  $0.34 \text{ w/m}^{3\circ}\text{K}$ ,*

*Dt- diferenca e temperatures jashte - brenda sipas kushteve projektuese  $22^{\circ}\text{K}$*

*$\eta$  - rendimenti i rekuperatorit – sipas kushteve te projektimit jo me pak se 55%*

*humbjet per njesi volumi  $4.1 \text{ W/m}^3$*

*Volumet llogarite*

*0.5 nderrime ajri ne ore me infiltrim*

*$35 \text{ m}^3/\text{h}$  per person ne ambjentin llogarites*

Ngarkesa e per gjithshme :

Llogaritje e ngarkeses se per gjithshme jane bazuar ne formulen e meposhtme:

$$Q = Q_T + Q_V$$

Kesaj ngarkese i zbriten perfitimiet e nxehtesise :

Nxehtesia e gjeneruar nga ndricimi, punonjesit dhe aparturat shtese te cdo ambjenti .

- *Sasia e nxehtesise e gjenerura per efekt te ndricimit eshte marre  $5 \text{ w/m}^2$*
- *Sasia e nxehtesise e gjeneruar nga punonjesit eshte marre  $80 \text{ w/person}$*
- *Sasia e nxehtesise e prodhuar nga aparurat eshte marre  $250 \text{ w / kompjuter}$*

#### 3.2.2 Ngarkesa ftohese :

Ngarkesa ftohese llogaritet ne transmetim, rrezatim dhe humbje ne ventilim .

Llogaritia e humbjeve me transmetim dhe ventilim behet njesoj si ngarkesa ngrohese . Temperatura e jashtme llogaritese eshte marre per Tiranen  $35^{\circ}\text{C}$

Kesaj ngarkese i shtohen perfitimiet e nxehtesise :



Nxehtesia e gjeneruar nga ndricimi, punonjesit dhe aparturat shtese te cdo ambjenti .

- *Sasia e nxehtesise e gjenerura per efekt te ndricimit eshte marre 5 w/m<sup>2</sup>*
- *Sasia e nxehtesise e gjeneruar nga punonjesit eshte marre 80 w/person*
- *Sasia e nxehtesise e prodhuar nga aparurat eshte marre 250 w / kompjuter*

Ne humbjet me rrezatim jane marre ne konsiderate siperfaqet e xhamit :

$$Q = S * K$$

*Q – humbjet e nxehtesise*

*S – Siperfaqa e hapsires qe rrezatohet*

*K – koeficienti i rrezatimit per oren e pikut qe varet nga lloji i xhamit dhe mbulimin me grila e perde . Ne kete rast K eshte marre 300w/m<sup>2</sup>*

Siperfaqet vertikale te mureve nuk merren ne konsiderate per humbjet me rrezatim .

Siperfaqet horizontale ( soleta ) llogariten me te njeften formule si humbjet me transmetim :

$$Q_T = S * u * D_t$$

*Q – humbjet e nxehtesise*

*S – siperfaqe e jashme e objektit ( mure , dritare , solete , dysheme )*

*u – koeficienti i humbjeve te nxehtesise , varesi e materialeve te perdonura*

*Dt- diferenca e relative temperatures jashte - brenda*

Diferenca e temperatures eshte relative pasi ajo merret parasysh jo si temperature e ajrit te jashtem por si temperature e siperfaqes se rezatuar.

- *Temperatura jashte 35°C*
- *Temperatura brenda 25° C*
- *Temperatura sip. se soletes 50°C*

Llogaritje e humbjeve ne ventilim jane bazuar ne formulaen e meposhtme:

$$Q_v = V * r * D_t * \eta$$

*Q – humbjet e nxehtesise,*

*V – Volumi i ajrit ventilues,*

*r – koeficienti i nxehtesise specifike te arit 0.34 w/m<sup>3</sup>K,*

*Dt- diferenca e temperatures jashte - brenda sipas kushteve projektuese 10 °K*

*η- rendimenti i rekuperatorit – sipas kushteve te projektimit jo me pak se 55%*

$$\text{Humbjet per njesi volumi } 1.9 \text{ W/m}^3$$

Volumet llogaritese:

- *0.5 nderrime ajri ne ore me infiltrim*
- *35 m<sup>3</sup>/h per person ne ambientin llogarites*

Ngarkesa e pergjithshme :

Llogaritje e ngarkeses se pergjithshme jane bazuar ne formulaen e meposhtme:

$$Q = Q_v + Q_T$$

Kesaj ngarkese i zbriten:

Nxehtesia e gjeneruar nga ndricimi, punonjesit dhe aparturat shtese te cdo ambjenti .

- *Sasia e nxehtesise e gjenerura per efekt te ndricimit eshte marre 5 w/m<sup>2</sup>*
- *Sasia e nxehtesise e gjeneruar nga punonjesit eshte marre 80 w/person*
- *Sasia e nxehtesise e prodhuar nga aparurat eshte marre 250 w / kompjuter*

### 3.3 Perzgjedha e sistemit dhe funksionimi i tij

Per perballimin e humbjeve te gjeneruara projekti eshte ndare ne dy sisteme. Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes me njesi fundore per cdo ambient ne varesi te tij , te tipit tokesor dhe toavanor qe do te perballoje humbjet me transmetim , dhe futja e ajrit te fresket te trajtuar qe merr parasysh humjet me ventilim.

Sistemi i pare do realizoje ngrohjen edhe ftohjen e ambientit ne varesi te kerkesave nepermjet njesive te brendshme te tipit VRF / VRV te lidhura ne grupe me njesi qendrore te kompensuara me uje. Ambiente e



brendshme jane pak te ekspozuara per sa i perket rrezatimit te drejtperdrejt pasi struktura e godine mundeson hijezim te mire te por per larmishmerine e perdomit dhe pasjen e ambjenteve me dendesi shume te ndryshme te popullimit kemi rekomanduar nje sistem me tre tuba. Ky sistem mundeson qe ne filim dhe fund sezioni ambjentet te mund te punojne ne menyre te pavarur per sa i perket selektimit sezonal , ngrohje apo ftohje. Ky regjimi qe cilsohet si regjim me rekuperim ul ndjeshme konsumin energjetik te ketij sistemi kondicionimi. Ky sistem do te kompensohet per ciklin frigoriferik nepermjet kullave ftohese ose ciklit te myllur gjeotermal. Koordinimi i punes nderjet kullave ftohese dhe unazes gjeotermale do te behet nga rregulatori klimatik ne varesi te temperatures se ajrit te jashtem per te ruajtur gjithmone nje rendiment maksimal te sistemit te ngrohje kondicionimit.

Per ventilimin e ambjenteve eshte marre ne konsiderate popullimi i tyre dhe furnizimi me  $35 \text{ m}^3/\text{h}$  per person ne cdo ambient . Njesite e ventilimit do te jene te tipit rekuperator te nxehtesise , me kembyes me pjastra me rryma te kunderta. Rendimenti minimal i pranuar do te jetë 55% te sasise se nxehtesise ne dalje , i parapelqyer do te ishte 73%.

Shperndarja e nxehtesise dhe ajrit te fresket si dhe largimi i ajrti te lodhur do te behet nga nje sistem kanalesh ajri te termoizoluar i paisur me dampera volumor , dampera te mbrojtjes ndaj zjarrit, grila te largimit te ajrit dhe difuzor .

### 3.3.1 Ngrohje – Kondicionimi

Si dhe e permendem me lart per ngrohjen edhe ftohjen e ambjentit ne varesi te kerkesave nepermjet njesive te brendshme te tipit VRF / VRV te lidhura ne grupe me njesi qendore te konpesuara me uje. Paisjet qendore te ngrohje kondicionimit jane pozicionuar ne ambjente teknike brenda godines . Lidhja ndermjet njesive qendore dhe atyre fundore do te behet nepermjet distributoreve specifik per kalimin nga sistem me tre tuba ne njesi te pavarura fundore. Lidhja e ketyre njesive do te realizohet me tuba bakri te termoizoluar sipas kerkesess per cdo fuqi te paisjes dhe perzgjedhjes nga software selektimit. Cdo ambient i brendshem do te kete termostat e tij te rregullimit te temperatures se brendshme , perzgjedhej se stines , volumin e ajrit te trajtuar . Parametrat e sistemit do te monitorohen nga sistemi i pergjithshem i kontrollit .

Per cdo grup qendror do te instalohet nje mates / ndares konsumi i cili komunikon me grupin VRV/VRF duke njojur ngarkesen e cdo njesie dhe lexuar oret e punes per cdo element ne grup si dhe me matesin elektrik te konsumit per te bere ndarjen e konsumit elektrik per cdo ambient perdorues.

Lidhja e njesive qendore me njesite e kompensimit te ciklit do te behet nepermjet nje rrjeti tubash celiku . rregullimi i prurjes sipas kerkeses per cdo njesi VRF/VRV do te realizohet nga paisje me valvola balancuese per rregullimin e prurjes . Gjithashtu qarku hidraulik do te permbaje te tere valvolat hapje myllje, fitrat mekanik , valvolat e rregullimit te fluksit, ajernxejresit autoamatik, treguesit e temperatures dhe presionit dhe bashkuesit antivibrat per lidhjen e pasiyeve me rrjetin hirdaulik.

Shperndarje e ujit kompensues do te realizohet nepermjet pompave qarkulluese nga satcioni i kompensimit drejt njesive konsumatore. Pompat do te kene motorr te tipit inverter dhe do te rregullojne prurjen ne varesi te differencës se temperatures hyrje dalje. Diferencia e projektuar eshte  $5^\circ \pm 1^\circ\text{C}$  . Brenda ketij diapazoni ne varesi te kerkeses se brendshme do te behet rregullimi automatik i sasise se fluidit kompensues .

Per te realizuar temperaturat e kerkuara ne ciklin kompensues jane projektuar dy burime regjenerativ , ajer i jashtem nepermjet kullave ftohese dhe energjia e tokes nepermjet puseve gjeotermal. Te dy keto burime jane burime te rigjenerueshme me kostot me te ulta te mundshme te shfrytezimit. Nje stacion klimatik do te rregullojte funksionimin ndermjet Kullave ftohese dhe puseve gjeotermal per sa i perket ciklit te temperatures se kompensimit. Temperatura ne ciklin e kompensimit do te tentohet te mbahet ne kufijt  $+ 10^\circ \pm 2$  per ciklin e ngrohjes dhe  $+25 \pm 2$  per ciklin e ftohjes. Sa here qe ku kusht nuk eshte i mundur te plotesohet nga njesite e kompensimit me ajer per shkak te temperaturave te jashtme te ulta ose te larta , sistemi do te kaloje ne regjimin gjeotermal. Kjo nderthurje duhet te rregullohet edhe manualisht gjate proceseve te sherbim mirmbajtjes ne kullat ftohese por edhe ne rast difektesh te mundshme. Rrjeti i puseve gjeotermal do te realizohet me cikel te myllur , me tubacione Pe te dimensioneve si ne projekt. Rregullimi i prurjeve per cdo pus do te rregullohet nepermjet valvolave balancuese te instaluar ne kolektoret e rrjeti te kompensimit Gjeotermal.

### Fitimet e nxehtesise nga gjeotermali:

$$Qc = L * \Delta T / R \quad \text{ku:}$$

$Qc$  – Fitimet e nxehtesise per nje shpim

$L$  – Gjatesia e tubacionit



$\Delta T$  – Diferenca e temperature (temperatura e tokes - temperatura e fluidit brenda tubacionit)

R – Rezistencat termike

Temperatura e tokes eshte marre  $15^{\circ}\text{C}$  (konstante per gjithe vitin) per puset vertikale.

Temperatura e fluidit ne tubacion eshte marre  $7^{\circ}\text{C}$

Rezistenza termike kemi rezistencen e tubacionit ku per materialin PE100 -SDR11 rezistenza eshte  $0.09 \text{ m}^2\text{K/W}$  dhe rezistenza e materialit mbushes (qe ne rastin tone eshte argile) eshte  $0.07 \text{ m}^2\text{K/W}$ . Rezistenza totale eshte shuma e rezistencave, ku  $R_{\text{tot}}=0.16 \text{ m}^2\text{K/W}$

Gjatesia e tubacionit per shpim eshte marre 200m

Pas zevendesimeve del qe fitimet per nje pus jane 10Kw. Meqe kemi 80 puse fitimet totale jane 800 kW.

Kjo vlore eshte teorike dhe mund te levize ne varesi te kushteve te jashtme dhe vlerave te terrenit, prandaj per llogaritjen eshte marre nje mesatare prej 40 W/gjatesi tubi, ku fitimet per nje shpim jane 8 kW dhe fitimet totale 640 Kw vlore kjo qe kenaq kriterin e projektimit.

Per cdo pjese te ndertuar te rrjetit hidraulik perpara mbulimit tyre do te kryhen provat hidraulike nen presion sipas procedures se meposhtme :

#### Prova teknike

Te mbushen me uje rrjeti i tubacioneve duke i lidhur dhe me kolektoret shperndares duke garantuar nxjerjen e plote te ajrit nga te gjitha qarqet .

Realizohen provat hidraulike me pompe manuale presioni vene te gjitha qarqet ne nje presion minimal prej 6 bar per nje periudhe prej 24 oresh .

Ne perfundim te provave presioni hidraulik duhet te jete stabel dhe ndryshimi ndryshimimi maksimal i presionit nuk duhet te kaloje 0.3 bar

Pas perfundimit me sukses te provave hidraulike mund te kalohet ne aplikimin e mbushjes

#### KUJDES

Nje ndryshim i presionit statik mund te ndodhe per shkak te ndryshimit te temperatures. Per ndryshime temperature prej +/- 10 grade presioni mund te ndryshoje me rreth 1 bar

#### 3.3.2 Ventilimi

Per ventilimin e ambjenteve eshte marre ne konsiderate popullimi i tyre dhe furnizimi me  $35 \text{ m}^3/\text{h}$  per person ne cdo ambient . Njesite e ventilimit do te jene te tipit rekuperator te nxehesise , me kembyes me pjastra me rryma te kunderta. Rendimenti minimal i pranuar do te jete 55% te sasise se nxehesise ne dalje , i parapelqyer do te ishte 73 %. Konstruksioni i njesive te ventilimit do te jete prej shasie me profile metalik te galvanizuar apo anodizuar , dhe mbyllje me panele te termoizluar perj materiali celik i galvanizuar dhe shkume Poliuretani ndermjet fletes se jashtme dhe te brendshme. Panelatura duhet te siguroje nje mberthim te mire me shsine per te mos lejuar rrjedheje te arit dhe garantur shtangesine e paisjes per nje pune pa zhurma dhe vibrome.

Ventilatoret mund te jene te tipit centrifugal ose aksial ne varesi te perzgjedhejs se entit prodhues per te garantuar prurjen dhe presioni sipas kerkesave ne projektin teknik .

Marrja e ajrit te fresket dhe largimi i tij do te behet nga cdo njesi e ndare per ne abjentin e brendshem te objektit kryesor i cili eshte ne shumicen e rasteve nje ambient i hapur me mjedisin rrethues. Largimi i ajrit per efekt fizik esht parashikuar ne qender te objektit kresor per te shfrytesuar ajrimin natyral te objektit si rruge e largimit jashte tij permes hapjes se kulmit.

Ajri i fresket dhe ai i lodhur ne dalje do ti neshtrohen filtrimit mekanik ne njesite e ventilimit . Flitri i parashikuar eshte i Klasit G3 , i pershtashem per tipologjine e perdonimit ne rastin tone . Per amjente me kerkesa me specifike ndaj madhesise se grimcave mund te perdoren edhe filra te klasit F5.

Largimi i ajrit per nje pjese te ambjenteve do te realizohet neperjet puseve egzistues te ajrimit te objektit. Keto puese perfundojne me hapje ne fasade dhe komunikim ne mjedisin e jashtem . Marja e ajrit te fresket do te kanalizohet deri ne hapejt e fasades ndersa largimi i ajrit te lodhur do te behet nga brenda amjentit ne rruge natyrale.

Shperndarja e nxehesise dhe ajrit te fresket si dhe largimi i ajrti te lodhur do te behet nga nje sistem kanalesh ajri te termoizoluar i paisur me dampera volumor , dampera te mbrojtjes ndaj zjarrit, grila te largimit te ajrit dhe difuzor per futjen e ajrit te trajtuar .

Shpejtesite e ajrit ne tubacione kryesore , degezime sekondare , dhe elemente fundore , filtra do te jene sipas :



• <i>Tubacion kryesore kondicionimi dhe ventilimi –</i>	<i>7 ÷ 4.5 m/sek</i>
• <i>Tubacione sekondare , degezime -</i>	<i>4.5 ÷ 3 m/sek</i>
• <i>Tubacione fleksibel -</i>	<i>3.5 ÷ 2 m/sek</i>
• <i>Tubacione te largimit te tymrave</i>	<i>8 ÷ 10 m/sek</i>
• <i>Filtrat e ajrit primar dhe atij qarkullues</i>	<i>1.5 ÷ 2 m/sek</i>
• <i>Difuzore dhe grila te projeksionit te ulet</i>	<i>1.2 ÷ 2 m/sek</i>
• <i>Difuzore te projetimit te larte</i>	<i>3.5 ÷ 7 m/sek</i>

*Humjet gjatesore per tubacionet nuk duhet ti kalojne 1.2Pa /ml*

*Niveli i zhurmave ne ambjente jo me i larte se 35 dB.*

*Pesha specifike e ajrit llogarites 1.2 kg / m<sup>3</sup>*

### **3.4. Konkluzione, rekomandime dhe pritshmerite e projektit.**

Perzgjedhja e sistemit eshte bere per te perfituar rendimentin maksimal nga pajisjet e kondicionimit dhe perzgjedhja e pajisjeve te kete pershtatjen maksimale me kerkesat e projektit arkitektonik. Sistemi i kompensimit gjeotermal do te garantoje punimin e njesive te jashtme brenda diapazonit te temperaturave per te cilat eshte prodhuar, por edhe ne rastet kur ky sistem kalon ne saturim diapazoni i funksionimit te pajisjeve mbetet perseri brenda parashikimit te prodhuesit duke garantuar pune pa nderprerje te sistemit.

Rekomandojme qe gjate fazes se testimeve te mblidhen te dhenat e sakta bazuar ne matje ne lidhje me efeksiteten e shkembimit gjeotermal per te verefikuar dhe saktesar ato teorike te perllogaritura ne projektim.

Me kombinimin kulle ftohese dhe sistem gjeotermal projekti synon te permiresoje rendimentin e njesive pompe nxehtesie (VRV) nga 3.5 nominali i perllogaritur ne fabrike ne 4.5 - 5 duke permiresuar shkembimin e nxehtesise ne lidhje me kushtet e jashtme reale, ose minimalisht te mbaje konstant rendimentin e parashikuar nga fabrikuesi.



## KAPITULLI NR.4

## PROJEKTI MBROJTJES NDAJ ZJARRIT

### 4.1 Te per gjithshme

Mbrojtja nga zjarri e godines se Piramides eshte realizuar bazuar ne standartin shqiptar dhe ato europeane ne fuqi. Gjate procesit te aplikimit te sistemit duhet qe te kontaktohet me autoritetet vendore te MKZSH per te siguruar nje testim dhe aprovim te ketij instalimi.

Duke marre ne konsiderate karakteristikat e ndertesesi si dhe destinacionin e tij, do te perdoren substanca shuarese si me poshte :

- *impiant i shuarrjes automatike te zjarrit ("sprinkler") per te gjithe godinen*
- *hidrante dn 50 per ambientet e brendeshme te godines dhe katet nentoke*
- *hidrante dn 80 per ambientet e jashtme te godines*
- *shuares portabel me pluhur ne ambientet korridore si edhe shuares me anidrid karbonik ne ambientet e vecanta te sherbimit.*
- *Sistem me aerosol per dhomat e serverave dhe paisjeve elektronike*

Ne funksion te sistemeve te mesiperm eshet projektuar rezervuar dhe sistem pompimi perkates sipas kushteve teknike dhe normave ne fuqi.

Impjanti i mbrojtjes nga zjari parashikon edhe lidhjen jashte me grupet e specializuara te skuadra te mbrojtjes nga zjari.

### 4.2 Sistemi me sprinkler

Sistemi i shuarjes automatike te zjarrit eshte projektuar i tipit "i lagur" duke patur parasysh temperaturat e ulta te moderuara te qytetit te Tiranes . Sprinklerat do te jene te tipit me element termosensibel. Prurja minimale e hedhesve te ujit eshte llogaritur ne varesi te presionit minimal te hedhesit te ujit dhe koeficientit te rekomanduar te fluksit.

Pozicionet e hedhesve jane percaktuar ne baze te rekomandimeve te normes EN 12845 dhe duke respektuar distancat ndermjet tyre si dhe mureve apo pengesave te aferta.

Procedura e llogaritjes dhe permasimit te ketij impianti eshte bere per cdo zone operative bazuar ne gjatesite ekuivalente, duke garantuar per hedhesin ne pozicionin me te pafavorshem nje presion prej 517 mbar, ndersa prurja llogaritet si prurja totale e te gjithe hedhesve te zones operative me te disfavorshme.

*Ne llogaritjet e sistemit automatik me sprinkler prurja llogariteze eshte 1278 l/min.*

### 4.3 Sistemi me Hidrante dn 50 dhe dn 80

Godina e piramides eshte e mbrojtur me sistem te vecante nga ai sprinkler me hidrante te brendshem, lidhje per makinen e zjarrfiksit dhe hidrante te jashtem ne te gjithe perimetrin e saj.

#### 4.3.1 Hidrantet e brendshem dn50

Ne te gjitha katet ne godine jane vendosur hidrante te brendshem dn 50, te pajisur me tubacion fleksibel; shuares zjari portabel me pluhur jane vendosur ne korridoret e cdo kati.

